



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 12

Prishtinë, më 22.04.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Valdete Bajrami, Teuta Haxhiu, Etem Arifi dhe Kujtim Paçaku.

Mungoi: Slavko Simiq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit UNICEF.

Të ftuar: Sami Kurteshi-Avokat i Popullit dhe Baki Gimolli-Ministria e Drejtësisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Argzon Muqaj-Kuvendi i Kosoves, Feride Podvorica-Ministria e Drejtësisë, Basri Berisha-IAP, Tefik Rrahmani-IAP, Arberita Kryeziu-IAP, Sakibe Jashari- Ambasada e Zvicrës, Teuta Hoxha-YIHR, Valmira Rashiti-YIHR, Feride Rushiti-KRCT, Alban Muriqi, KRCT, Visar Bivolaku-EUO/EUSR, Lejla Selimi-OSBE dhe Arta Xhylani-Praktikante e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 10;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Avokatin e Popullit;
4. Shqyrtimi i peticionit,
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 10

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 07.04.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Avokatin e Popullit

Kryetarja- Pasi i përshëndeti të pranishmit, i njoftoi anëtarët e Komisionit se sponsoruese e Projektligjit për Avokatin e Popullit ka qenë Ministria e Drejtësisë. Duke u ndërlidhur me projektligjin ajo theksoi se janë të mirëseardhura disa ndryshime, të cilat kanë qenë e nevojshme të bëhen, për arsye se kanë hasur problem në zbatimin e tyre në praktikë. Më pas ajo ia dha fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë me qëllim të prezantimit të projektligjit.

Baki Gimolli – Theksoi se Ministria e Drejtësisë ka pasur si prioritet hartimin e këtij projektligji pasi që janë marrë parasysh të gjitha problemet dhe vërejtjet që kanë ndodhur në praktikë. Po ashtu ai tha se janë marrë parasysh rekomandimet që janë marrë nga Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian. Duke iu referuar projektligjit ai e informoi Komisionin se projektligji për Avokatin e Popullit ka qenë projektligji i cili më së shumti i është nënshtruar procesit të konsultimeve dhe në këtë mënyrë janë marrë parasysh rekomandimet, pasi që ky projektligj ka qenë i lidhur edhe me çështjen e liberalizimit të vizave. Duke debatuar rreth përmbajtjes së projektligjit ai theksoi se projektligji posedon dispozita miks të karakterit material, procedural, si dhe organizativ sepse rregullon çështje organizative në institucionin e Avokatit të Popullit. Rreth përmbajtjes së projektligji ai tha se përmbajtja është e bazuar në ligjin bazik duke iu referuar kompetencave të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, pastaj çështje të tjera rreth mënyrës së punës së institucionit.

Kryetarja duke u ndërlidhur me përmbajtjen e projektligjit tha se projektligji i plotëson kushtet formale juridike dhe më pas ia dha fjalën debutuesit të radhës.

Sami Kurteshi – I informoi anëtarët e Komisionit se Institucioni i Avokatit e Popullit, si zbatues i Ligjit për Avokatin e Popullit, ka bashkëpunuar më Ministrinë e Drejtësisë gjatë kohës së hartimit të projektligjit. Ai në vazhdim tha se projektligji i cili është në shqyrtim sot ka ndryshuar në tekst nga ai i cili është dërguar prej Ministrisë së Drejtësisë në Qeveri, mirëpo ai tha se për këto do të analizohen më vonë nen për nen dhe do të ketë mundësinë e diskutimit rreth atyre çështjeve.

Kryetarja duke dashur që të jetë sa më gjithëpërfshirëse me aktorët të cilët kanë qenë pjesëmarrës në hartimin e projektligjit, kërkoi edhe nga shoqëria civile që të diskutojnë lidhur me projektligjin. Po ashtu ajo theksoi se do të jetë kooperuese më aktorët e tjerë brenda Kuvendit që më parë janë marrë me shqyrtimin e Ligjit për Avokatin e Popullit në mënyrë që në fund të dalin me një ligj sa më mirë të hartuar.

Feride Rushiti – Duke i informuar anëtarët e Komisionit rreth fushëveprimit të organizatës joqeveritare, ku ajo bën pjesë, theksoi se përqendrimi i tyre shfaqet në institucionet apo organet kompetente ku mbahen personat e ndaluar. Po ashtu ajo theksoi se në periudha vjetore ata paraqesin raport në bazë të të cilit tregohet gjendja e respektimit të të drejtave të njeriut nëpër institucionet e lartë theksuara. Në këto drejtime që ajo përmendi se kanë bashkëpunuar ngushtë me Avokatin e Popullit pasi që të dyja palët në këtë rast e kanë qëllimin e njëjtë që d.m.th., mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Lidhur me përmbajtjen e projektligjit ajo theksoi se kanë përgatitur një shkresë në të cilën paraqesin qartë pakënaqësitë e tyre sepse në përmbajtjen e projektligjit përjashtohet roli i shoqërisë civile.

Kryetarja – I rikujtoj anëtarëve të Komisionit që e kanë materialin përcjellës së bashku me projektligjin dhe do ta kenë kohën e mjaftueshme për analiza në mënyrë që të japin kontributin e tyre me qëllim të hartimit sa më të mirë të ligjit. Pas kësaj kryetarja e hapi diskutimin tek anëtarët e Komisionit në mënyrë që ta japin mendimin e tyre për projektligjin.

Teuta Haxhiu – Pasi që i përshëndeti të pranishmit, theksoi se anëtarëve të Komisionit ju nevojitet kohe për analizimin e materialit në mënyrë që të japin kontributin e tyre lidhur me projektligjin në fjalë. Ajo këtë e arsyetoi edhe me faktin se është shqyrtimi në parim i projektligjit dhe analizat më të thella do të bëhet në të ardhmen gjatë procedurave të mëtutjeshme pasi që projektligji të miratohet në Kuvend. Ajo propozoi që të miratohet projektligji në parim dhe pastaj të punohet në hapat pasues.

Salihe Mustafa – Duke u ndërlidhur theksoi se dhe pse projektligji është për miratim në parim ajo ka nevojë për disa përgjigje nga të pranishmit. Ajo e ngriti çështjen e mospjesëmarrjes në politike të kandidatit për pozitën e Avokatit të Popullit, sipas saj kandidati duhet të jetë jopolitik, sepse sipas mendimit të saj dështimet e fundit që kanë ndodhur në zgjedhjen e Avokatit të Popullit kanë ndodhur edhe për këtë shkak, andaj ajo e ngriti këtë çështje për debat sepse kjo është e përcaktuar edhe në nenet e projektligjit. Ajo ishte e mendimit që të qartësohet koha se sa duhet të jetë pa ushtruar funksion politik kandidati për Avokat të Popullit.

Kujtim Paqaku – Duke u ndërlidhur me përmbajtjen e projektligjit përmendi nenin 6, 1.3 i cili flet për karakterin dhe ndershmërinë e lartë të kandidatit për Avokatin e Popullit. Sipas tij kush mundet që ta bëjë përcaktimin se kush ka karakter dhe vlera morale dhe kush nuk ka. Ndërsa te neni 7 në të cilin përcaktohet papajtueshmëria e ushtrimit të funksioneve të tjera, përveç atyre që i autorizon Kuvendi. Ai tha se është e paqartë cilat funksione mund t'i kryej Avokati i Popullit. Lidhur me nenin 21 që ka të bëjë me procedurat pas pranimit të ankesës, ai kërkoi informacione se si do të duhej të veprohej në këto raste kur ankesa paraqitet nga personi anonim, ose nga personi që dëshiron të jetë anonim.

Mexhide Topalli – Mjaku – Duke mos dashur që të debatojnë hollësisht për projektligjin pasi që ishte takimi i parë dhe miratimi në parim i tij, ajo u ndal te neni 8.8 i projektligjit në të cilin përcaktohet lista e ngushtë e kandidatëve që i përcjellën Kuvendit për përzgjedhje të kandidatit për Avokat të Popullit. Ajo ishte e mendimit që kjo pikë të qartësohet në mënyrë që mos të ketë problem praktike sikur që ka ndodhur herën e fundit në Komisionin për të Drejtat e Njeriut. Po ashtu rreth nenit 17 ajo ishte e mendimit që duhet t'i lejohej një kompetencë e tillë Avokatit të Popullit në mënyrë që të ketë mundësi që pa paralajmërim t'i vizitojë burgjet në mënyrë që të evidentojë se a ka shkelje të të drejtave të burgosurve, po ashtu edhe tek institucionet e tjera ku është e nevojshme që të ndërhyjë Avokati i Popullit.

Mytaher Haskuka- Tha se do t'i kemi parasysh komentet e BE-se dhe të shoqërisë civile sa i përket Projektligjit për Avokatin e Popullit, te neni 6 për zgjedhjen e Avokatit të Popullit tha se është mirë të kërkohet edukimi pasuniversitar, sepse herën e kaluar është dashur t'i ftojme të gjithë aplikantët, dhe bëri pyetje se a duhet të shtohet aspekti i menaxhimit, sepse Avokati duhet të jetë edhe menaxher i mirë, a duhet me bërë një paragraf ku parashihen sanksione për institucionet që nuk i përgjigjën shkresave të Avokatit të Popullit.

Baki Gimolli- Tha se ky ligj është në harmoni dhe është vlerësuar edhe nga Brukseli se kusht është edhe për liberalizim të vizave.

Teuta Haxhiu- Tha se nuk është me rëndësi se kush e ka vlerësuar, u përmend nga Avokati i Popullit se ndjemi ata që kemi me zbatua këtë ligj. Ne jemi ata që e votojmë, nuk është me rëndësi me i treguar botës se ne po bëjmë ligje, është me rëndësi me treguar se po i zbatojmë ligjet dhe kështu tregohet se çka po bëjmë. Mua me intereson me u bërë një ligj për popullin e Kosovës.

Sami Kurteshi- Tha se i vlerëson vërejtjet e deputetit Paqaku në nenin 21 për viktimat që frikësohen, ajo është shumë me rëndësi për zbatim se sa çështjet e tjera, kemi një obligim me ruajt konfidencialitetin. Në nenin 6 pika, 1 që e përmendi deputetja Mustafa, ai tha se është shumë njeri politik ka të kryer shkencat politike, tha se nuk duhet me qenë njeri me librezë partiake, sepse librezë partiake kërkon lojalitet zyrtarisht, për këtë unë kam kërkuar që për stafin e IAP, të mos vlejnjë normat e shërbimit civil.

Ishte pyetje e drejtë se kush e cakton ndershmërinë moralin, kemi kërkuar edhe më parë me hequr këtë, por na u është thënë se duhet me mbetur, ligji cakton kush është i ndershëm që duhet të jetë në harmoni me normat morale të shoqërisë. Ai lidhur me pyetjen e deputetes Mjaku tha se neni 8, se si të bëhet zgjidhja kur kemi kandidatë me vota të barabarta sikur herën e kaluar që është proceduar lista për Avokat të Popullit me 4 kandidatë, mendoj se nuk ka asgjë të keqe veç se mundësi më e mirë për të zgjidhur më të mirin, krejt kjo varet nga kuvendi se me sa kandidatë vendos të procedojë, ai tha se Avokati i Popullit dhe zëvendësit po ballafaqohet edhe me pagat.

Baki Gimolli- Tha ne i kemi parapa në memorandum shpjegues të gjitha arsyetimet pse i kemi pranuar dhe pse si kemi pranuar rekomandimet. Sa i përket pagave propozimi i Ministrisë së Drejtësisë ka qenë ashtu si ju keni rekomanduar dhe i kemi përfshirë edhe rekomandimet e tjera, por Qeveria disa nuk i ka pranuar.

Kujtim Paçaku- Pyeti Avokatin e Popullit pasi që nuk keni dështuar deri më tani, sa janë bashkëpunëtorët tjerë nëpër qendra sikur ju, dhe sa nga ju e kanë vizituar këto ditë Gjakovën dhe Mitrovicën për rastet e dhunimit dhe vdekjeve, ndërsa çështja tjetër shqetësuese sipas tij është te partitë politike, se duhet ketë afat kohor p. sh. 3 muaj , 2 ,3, apo 4 vjet që nuk merren më politikë, pasi që sot të gjithë si qytetarë anojmë nga një parti politike, sepse po ndodh që vetëm një jave para, po jep dorëheqje dhe po aplikon për Avokat të Popullit. Po ashtu ai bëri pyetje edhe për Ferdie Rushitin (Qendra për Rehabilitim dhe Mbrojtje të Torturës) se për cilën periudhë të torturave bëhet fjalë.

Feride Rushiti- Tha se bëhet fjale për torturat gjatë luftës.

Kryetarja-Propozon për votim të projektligjit në parim të avokatit të popullit që të procedohet në kuvend për shqyrtim në lexim të parë.

Kryetarja-Konstatoi se Komisioni me 8 vota për vendosi të nxjerrë këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji për Avokatin e Popullit dhe propozon që i njëjti të shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Peticionit

Kryetarja- Lidhur me peticionin për punëtorët e Hotelit Grand ajo tha se ne, si Komision, e kemi shqyrtuar këtë peticion, ku adresohet drejt, proces i dobët i privatizimit ka cenuar të drejtat e tyre. Mirëpo është mirë që ky peticion të bartet te Komisioni Funkcional për Zhvillimit Ekonomik, që do të japin një pasqyrë, pasi që kjo çështje ka një punë disa vite, që më me precizitet do të fokusohet në zgjidhjen e kërkesës.

Kryetarja konstatoj se komisioni me 7 vota për vendosi që të nxjerrë këtë:

Përfundim

Peticioni të procedohet për shqyrtim, në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, që në aspektin funksional do ta analizojnë, pastaj të kthehet përsëri në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, për të nxjerrë rekomandimet e duhura.

Të ndryshme

Kryetarja- I njoftoi për javën e të pagjeturve, që mbahet me përkrahje të kryetarit të Kuvendit, Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur dhe Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Persona të Pagjetur dhe Peticione, po ashtu njoftoi edhe për Seancën Plenare të 27 prillit që i dedikohet personave të pagjetur.

Teuta Haxhiu- Tha që do të duhej të ishte një organizim dhe koordinim i orari gjatë asaj dite, sepse në Meje të Gjakovës është organizimi kryesor atje dhe shoqata e të pagjeturve në Gjakovë e cakton kur realizohet dhe kush të flasë, e si qytetare dhe deputete e asaj rrethine ajo do duhej të flasë në emër të Komisionit, e në orën 10:00, është seanca, ajo pyeti sa do të mund të arrihet koordinimi i takimeve.

Mexhide Mjaku-Topalli- Tha se a do të shkohet individualisht apo, si Komision në homazhet, siç është rasti në Reçak dhe Kaçanik?

Kryetarja- Tha se i ka koordinuar takimet Kuvendi, por edhe gjatë takimit më krye parlamentar do të precizojë këto çështje që të jemi më të njoftuar rreth asaj dite. Ajo tha se çështje tjetër sipas planit të punës ka qenë kërkesë e Pacakut vizita në njësitë komunale për të drejtat e njeriut. Andaj propozon që kur të realizohet një vizitë jashtë Prishtinës, do të thotë në qytetet e tjera, njëkohësisht krahas vizitave për monitorimin e ligjit për të verbëritë, të vizitohen edhe njësitë komunale! Pastaj edhe zyrat për barazi gjinore, sepse aty ka përkime më qeverisjen lokale.

Salihe Mustafa- Raporton për punën e grupit punues për monitorimin e ligjit për personat e verbër, për vizitat e realizuara në Shoqatën qendrore e të verbërve në Prishtinë, Shoqatën e të verbërve në Gjilan, MPMS, MSH dhe MASHT që kanë arritur të marrin informata të shumta dhe efikase për këtë monitorim, gjithsesi duhet edhe një vizitë në Pejë pasi që atje është edhe shkolla speciale për të verbër. Ajo tha se nuk mjafton koha për ta vizituar Gjakovën, po ashtu edhe vizitat më kryetarët e komunave do të ishte një rezultat më real për punën e tyre, por propozon që nëse kanë ide anëtarët e Komisionit për ndonjë vizitë tjetër që ndërlihet me këtë çështje.

Mytaher Haskuka- Tregon për raste të caktuara për persona me aftësi të kufizuara që ka pranuar dy ankesa, ku kanë pasur probleme të tërheqin vetura në kufi e kanë të bllokuar veturën, pasi që rregullorja e doganës thotë se personi që ka patentë shoferi mund të marrë veturën, e kjo gjë është e pamundur sepse të verbëritë nuk kanë patentë, shoqëruesi

është ai që i ndihmon ata, e duhet aplikuar ligjin edhe për këta persona, gjë tjetër është edhe mos lirimi nga dogana që iu takon me ligj, pra po ndryshohen këto rregulla varësisht prej doganierëve, andaj jep si propozim vizitë në Doganën e Kosovës.

Salihe Mustafa- E merr në konsideratë idenë e Mytaher për këtë vizitë dhe kërkon një procedurë më të shpejtë të punës për këtë monitorim që të japim rezultate dhe të procedojmë më tutje.

Kryetarja tregoi që ka biseduar me zyrtarët e ministrisë që merren me konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Ata kanë vetura të deponuara që nuk përdoren as nga funksionarët më të mëdhenj, dhe si propozim nëse Komisioni pranon do të ishte një ndihmë sado, që për këto kategori të specifikuara të jepen këto vetura në mënyrë ligjore, por që në të ardhmen të mos kenë problem pasi që janë të konfiskuara.

Lejla Selimi- Përfaqësuese e OSBE-së njofton Komisionin për vizitën që Shefi i misionit për Kosovë, që është edhe tani i pranishëm në Kosovë dëshiron të takohet me disa nga komisionet parlamentare, e krahas kësaj edhe me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që të shpaloset puna, sfidat dhe planet e komisioneve ndërsa më kryetarët e komisioneve 30 minuta para takimit, dhe kërkon të caktohet një datë për takim pasi që këto takime do të realizohen në fillimin e muajit maj.

Kryetarja- propozoi që për këtë do të njoftohen me kohë dhe në mbledhjen e ardhshme të caktohet data e takimit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi